



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË
DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 119/5 prot.

Tiranë, më 30.5. 2022

MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BUXHETIT
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, Tiranë

Lënda: Mbi raportet e monitorimit për 4-mujorin e vitit 2022

RELACION

Bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ligjin nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.3.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore”, është kryer monitorimi i zbatimit të buxhetit për Institucionin e Komisionerëve Publikë për 4-mujorin e parë të vitit 2022. Zbatimi i këtij buxheti është mbështetur në drejtimet kryesore të miratuara me vendimet e Mbledhjes së Komisionerëve dhe Grupit të Menaxhimit Strategjik. Fondet buxhetore janë shpenzuar bazuar në parimin e ligjshmërisë, economicitetit, efikasitetit dhe eficiencës. Në vijim paraqiten, në mënyrë të përmbledhur, treguesit e realizimit të fondeve buxhetore për këtë periudhë, nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë me ata të planifikuar.

Në mijë lekë

Emërtimi	Buxheti vjetor (plani)	Buxheti vjetor i rishikuar (plani)	Buxheti 4-mujor (plani)	Realizimi 4-mujor (fakti)	Realizimi në %
Shpenzime korente	73,728	71,335	23,288	21,762	93%
Shpenzime kapitale	2,000	2,000	-	-	-
TOTALI	75,728	73,335	23,288	21,762	93,4%

Në buxhetin e miratuar me ligjin nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, për Institucionin e Komisionerëve Publikë janë akorduar 7,400 mijë lekë në shpenzime operative, 2,000 mijë lekë në investime dhe 66,128 mijë lekë në paga dhe sigurime shoqërore. Buxheti në shpenzime korente përputhej me kërkesën e institucionit, ndërsa buxheti në shpenzime kapitale (investime) është miratuar, ndërkohë që institucioni nuk ka hartuar kërkesa buxhetore në këtë zë, siç jeni në dijeni, kushtëzuar nga përfundimi i mandatit kushtetues të institucionit. Me ligjin nr. 16/2022, mandati kushtetues i Komisionerëve Publikë përfundon në datë 31.12.2024. Fondet buxhetore, në total 75,728 mijë lekë, janë rishikuar me aktin normativ nr. 3, datë 12.3.2022, të Këshillit të Ministrave, dhe u pakësuan me 2,393 mijë lekë në shpenzime korente. Gjatë 4-mujorit, gjithashtu, u krye avancim fondi në shpenzime për paga, në vlerën 1,300 mijë lekë, për të mbuluar efektin e shtesës për vështirësi për Këshilltarët e Njësisë Ligjore, në përputhje me dispozitat ligjore, si dhe parashikuar në dokumentin e programit buxhetor afatmesëm. Vlera totale e buxhetit arriti në 73,335 mijë lekë dhe për 4-mujorin në 23,288 mijë lekë. Performanca e realizimit të fondeve buxhetore për këtë periudhë është në nivelin rreth 93,4%.

Në mënyrë analitike, performanca e realizimit të shpenzimeve për këtë periudhë, për Institucionin e Komisionerëve Publikë, paraqitet si në vijim:

Realizimi i buxhetit sipas artikujve ekonomikë

Në mijë lekë						
Artikulli	Emërtimi	Buxheti vjetor (plani)	Buxheti vjetor i rishikuar (plani)	Buxheti 4-mujor (plani)	Realizimi 4-mujor (fakti)	Realizimi në %
600+601	Paga dhe sigurime	66,128	64,475	21,328	20,430	95.8 %
602+606	Shpenzime për mallra dhe shërbime, dhe fondi i veçantë	7,600	6,860	1,960	1,332	68%
231	Shpenzime kapitale	2,000	2,000	0	0	0 %
	TOTALI	75,728	73,335	23,288	21,762	93,4%

1. Artikulli 600 dhe 601, “Shpenzime personeli”, buxheti vjetor i alokuar në fillim të vitit 2022 për këtë zë është 66,128 mijë lekë, buxhet i cili do të mbulonte nevojat e institucionit në fushën e pagave për të gjithë vitin, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Por për shkak të pakësimit me aktin normativ nr. 3, datë 12.3.2022 të fondit të pagave, me miratimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, u krye avancimi i fondeve në muajin prill, për mbulimin e shpenzimeve në paga dhe sigurime shoqërore.

Buxheti në paga dhe sigurime shoqërore, pas rishikimit, ka arritur në vlerën 64,475 mijë lekë, buxhet i cili nuk mbulon pagat e punonjësve për gjithë vitin 2022.

Me Vendimin nr. 37/2022, Kuvendi i Shqipërisë miratoi disa ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr. 94/2017, “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionerëve Publikë”. Pas këtyre ndryshimeve në përlogaritjen e buxhetit në paga, por edhe si rezultat i rritjes së pagës minimale në shkallë vendi, pagës maksimale dhe minimale për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe shpenzimeve në paga për 2 punonjësit me kontratë të përkohshme, është e nevojshme që të rishikohet ky buxhet. Për këtë arsye i jemi drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për transferimin e fondeve buxhetore nga artikulli 602 “Shpenzime për mallra dhe shërbime” në artikullin 600 dhe 601 “Paga dhe sigurime shoqërore” për të mbuluar nevojat në këtë artikull buxhetor.

Performanca e realizimit të planit në këtë artikull buxhetor, për 4-mujorin e vitit 2022, është në nivelin 95.8%.

2. Artikulli 602, “Shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera”, buxheti i miratuar në fillim të vitit në këtë artikull, për vitin 2022, është 7,400 mijë lekë, dhe pas rishikimit të buxhetit me aktin normativ nr. 3, datë 12.3.2022, të Këshillit të Ministrave, buxheti në shpenzime operative u pakësua me 740 mijë lekë, duke arritur në vlerën 6,660 mijë lekë.

Performanca e realizimit të buxhetit në “Shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera”, në bazë të analizës krahasimore plan-fakt, për 4-mujorin e vitit 2022, është në nivelin 68%.

Gjatë kësaj periudhe janë kryer disa procedura prokurimi, blerje me vlerë të vogël, materiale pastrimi, kancelari, tonera, si dhe procedura të thjeshtuara, blerje materiale dhe shërbime: mirëmbajtje e faqes *ëeb*, shpenzime larje automjeti, abonime etj.

Gjithashtu janë kryer shpenzime nga buxheti dhe janë lidhur kontrata për parkim automjeti, telefoni celulare, si dhe shpenzime të zakonshme, shpenzime për energji, ujë, postë, taksat e Bashkisë etj.

Theksojmë se niveli i realizimit të këtyre fondeve buxhetore varet edhe nga vonesat në përfundimin e procedurave të prokurimit, për shkak të tërheqjes së operatorëve dhe vështirësive në studimin e tregut, për shkak të ndryshimeve të vazhdueshme të çmimeve të tregut.

Një pjesë e shpenzimeve të planifikuara janë rishikuar dhe do të rishikohen në vijim në kuadër të ekonomizimit të fondeve buxhetore, duke kryer rishpërndarje të tyre ose përcaktimit të prioriteteve për plotësimin e nevojave më të domosdoshme dhe më emergjente.

Analitikisht, shpenzimet operative në këtë periudhë janë realizuar si më poshtë:

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	602	
		Plan	Fakt
1	Materiale e shpenzime zyre	693	588
2	Shërbime nga të tretë (energji, ujë, postë, telefon, parkim etj.)	737	659
3	Materiale dhe shërbime speciale	20	16
4	Shpenzime transporti + udhëtimi	10	4
5	Shpenzime mirëmbajtje të zakonshme	249	0
5	Shpenzime të tjera speciale	51	35
	TOTALI	1,760	1,302

3. Artikulli 231, “Shpenzime kapitale”, buxheti i miratuar për këtë artikull për vitin 2022 është 2,000 mijë lekë. Gjatë këtij 4-mujori nuk ka pasur rishikime të tij, megjithëse ky fond tejkalon kërkesën e institucionit për sa i përket këtij zëri të buxhetit, paraqitur kjo në Projektbuxhetin 2022-2024, kërkesë e cila u kushtëzua nga përfundimi i mandatit kushtetues të institucionit, siç u theksua dhe më lart.

Gjithsesi, në fillim të vitit u krye detajimi i këtij fondi për vitin 2022, në muajt maj dhe qershor me 1,000 mijë lekë, në zërin “Blerje pajisje e orendi zyre” dhe 1,000 mijë lekë, në zërin “Blerje pajisje elektronike”. Ky buxhet nuk është planifikuar për t’u realizuar në këtë periudhë dhe, në vijim, është kërkuar pakësimi i këtij fondi dhe transferimi i tij në fondin e pagave, në rast të rishikimit të buxhetit me akt normativ, duke përcaktuar nevojat më të domosdoshme në investime, si dhe duke marrë në konsideratë jetëgjatësinë e asteve dhe mandatin kushtetues të institucionit.

Në përfundim vlerësojmë se buxheti i 4-mujorit të parë të vitit 2022 është zbatuar në përputhje me dispozitat ligjore dhe konform fondeve buxhetore të miratuara për vitin 2022, duke synuar një performancë në rritje të realizimit të tyre, në të gjithë zërat e shpenzimeve, si dhe plotësimin e nevojave të domosdoshme për ecurinë e aktivitetit institucional.

Nëpunës Zbatues

Adelina Kastrati



Nëpunës Autorizues

Alketa Çeli

ANEKSI nr.1 "Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve"

ne 000/leke



Emri i Grupit		Komisioneret Publike				Kodi i Grupit		63	
Programet		Shpenzimet e Institucionit							
Titulli	Emertimi	(1) Fakti i vitet paraardhes Viti 2021	(2) PBA Viti 2022	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2022	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2022	(5) Buxheti Vjetor Plani i Periudhes 4 mujore /progresiv	(6) Fakti i Periudhes/progresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca	
0001	Programi 03360	68,776	75,800	75,728	73,335	23,288	21,762	-1,526	
Totali i Shpenzimeve te Institucionit		68,776	75,800	75,728	73,335	23,288	21,762	-1,526	
Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit					-				
Totali		68,776	75,800	75,728	73,335	23,288	21,762	-1,526	

Nepunesi Zbatues	Emri	Adelina Kastrati	Kordinatori i GMS/Nepunesi Autorizues	Emri	Alketa Çeli
	Firma			Firma	
	Data	27.5.2022		Data	27.5.2022

ANEKSI nr.2 "Raporti i Shpenzimeve të Programit sipas Shpenzimeve"

ne 000/leke


Emri i Grupit		Komisionerët Publikë					Kodi i Grupit	63
Programi		Veprimtaria e Komisionerit Publik					Kodi i Programit	03360
Art.	Emertimi	(1) Fakti i vitit paraardhes Viti 2021	(2) PBA Plan 2022	(3) Buxheti Vjetor Viti Plan Fillestar viti korrent 2022	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2022	(5) Buxheti Vjetor Plani i Periudhes 4 mujore /progresiv	(6) Fakti i Periudhes/progresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca
600	Paga	59,279	59,528	59,528	58,040	19,128	18,273	-855
601	Sigurime Shoqërore	6,465	6,600	6,600	6,435	2,200	2,157	-43
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	3,002	7,400	7,400	6,660	1,760	1,302	-458
603	Subvencione							0
604	Transferta Korente të Brendshme							0
605	Transferta Korente të Huaja							0
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	30		200	200	200	30	-170
Nen -Totali	Shpenzime Korrente	68,776	73,528	73,728	71,335	23,288	21,762	-1,526
230	Kapitale të Patrupëzuara							0
231	Kapitale të Trupëzuara	0	0	2,000	2,000	0	0	0
232	Transferta Kapitale							0
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	0	0	2,000	2,000	0	0	0
230	Kapitale të Patrupëzuara							0
231	Kapitale të Trupëzuara							0
232	Transferta Kapitale							0
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	0	0	0	0	0	0	0
Totali	Shpenzime Kapitale	0	0	2,000	2,000	0	0	0
Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti							0	
Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardh.jashte limiti)		68,776	73,528	75,728	73,335	23,288	21,762	-1,526


Nepunesi Zbatues	Emri	Adejina Kastrati	Kordinatori i GMS/Nepunesi Autorizues	Emri	Alketa Çeli
	Firma			Firma	
	Data	27.5.2022		Data	27.5.2022

ANEKSI nr.3 "Raporti përmbljedhes i realizimit të treguesve të performances/produkteve të programit"

Emri i Grupit	Komisionerët Publikë	63
Programi	Veprimtaria e Komisionerit Publik	5350

Kodi	Emertimi i Treguesit të Performances/Produktit	Njesia matese	Sasia Faktike (sipas vitit 2021)	Shpenzimet (sipas vitit 2021)	I			II			III			IV			Luhatjet në Koston për Njësi			Komente
					Kosto për Njësi (sipas vitit 2021)	Sasia (sipas planit të vitit 2022)	Shpenzimet (sipas planit të vitit 2022)	Kosto për Njësi (sipas planit të vitit 2022)	Sasia (sipas planit të rishikuar të vitit 2022)	Shpenzimet (sipas planit të rishikuar të vitit 2022)	Kosto për Njësi (sipas planit të rishikuar të vitit 2022)	Sasia Faktike për 4 muajt e vitit 2022	Shpenzimet Faktike për 4 muajt e vitit 2022	Kosto për Njësi për 4 muajt e vitit 2022	V = IV - I	V = IV - II	V = IV - III			
Produkti 1	Numer Çështjesh të njoftuara nga KPK, të shqyrtuara nga Komisionerët Publikë brenda afatit ligjor	nr. Çështjesh	171	68,776	402	160	73,728	461	140	71,335	510	33	21,762	659	64%	43%	29%			
Produkti 2	Pajisje komp/mobilie/pajisje zyrtare	sete pune	5	0	0	9	2,000	222	0	2,000	#DIV/0!	0	0	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!			
Totali				68,776	402	169	75,728	683	140	73,335	#DIV/0!	33	21,762	#DIV/0!				0		



Nepunesi Zbatues	Emri	Adelina Kastrati
	Firma	
	Data	27.5.2022

Kordinatori i GMS/Nepunesi Autorizues	Emri	Alketa Çeli
	Firma	
	Data	27.5.2022

ANEKSI nr.4 "Raporti i realizimit te objektivave te politikës se programit"

Periudha e Raportimit: 4 mujori 2022



Kodi i Programit	3360	Emertimi i programit:						Komente	
Qellimi 1	Procesi i Rivleresimit te gjyqtareve dhe prokuroreve ne Republiken e Shqiperise ka per qellim garantimin e e funksionimit te shtetit te se drejtes, pavaresine e sistemit te drejtesise si dhe rikthimin e besimit te publikut tek institucionet e ketij sistemi	Veprimtaria e komisionerit Publik							
Objektivat e politikës:		Kodi i Treguesit te Performances/Produktit	Emertimi i Treguesit te Performances/Produktit	Niveli faktik i vitit 2021	Niveli i planifikuar ne vitin 2022	Niveli i rishikuar per 4 mujorin e vitit 2022	Niveli faktik per 4 mujorin e vitit 2022	% e realizimit te Treguesit te Performances/Produktit	
Objektivi 1.1	Mbrojtja e interesit publik gjate kryerjes se procesit te rivleresimit, respektimi i parimit te paanesise dhe pavaresise, procesit te rregullit ligjor, transparences dhe frymes se bashkepunimit ndermjet dy komisionereve publike, Operacionit Nderkombetar te Monitorimit dhe institucioneve te tjera."								
	Numer Çeshtjesh te njoftuara nga KPK, te shqyrtuara nga Komisioneret Publike brenda afateve ligjore	A	Shqyrtim i vendimeve te njoftuara nga KPK	171	160	160	33	21%	

Nepunesi Zbatues	Emri	Adelina Kastrati	Kordinatori i GMS/Nepunesi Autorizus	Emri	Alketa Çeli
	Firma			Firma	
	Data	27.5.2022		Data	27.5.2022

ANEKSI nr.5 "Projektet e investimeve me financim te brendshem dhe me financim te huaj"

Projektet me financim te brendshëm (ne 000/leke)

Kodi projektit	Emertimi i projektit	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projektit	Buxheti i Kontraktuar	Plani i buxhetit viti 2022	Realizimi Progresiv nga fillimi i vitit 2022	Realizimi për periudhën e raportimit vjetor	Realizimi Progresiv nga fillimi i projektit deri në periudhën aktuale	Komente
M630002	Pajisje dhe mobilje zyre	-				1,000	-	-	-	Planifikuar per tu perdorur ne muajin maj dhe qershor
M630013	Pajisje kompjuterike	-				1,000	-	-	-	Planifikuar per tu perdorur ne muajin maj dhe qershor
TOTALI		-			-	2,000	-	-	-	

Nepunesi Zbatues	Emri	Adelina Kastrati	Kordinatori i GMS/Nepunesi Autorizues	Emri	Alketa Çeli
	Firma			Firma	
	Data	27.5.2022		Data	27.5.2022